



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË DREJTORIA E KOMUNIKIMIT DHE BURIMEVE NJERËZORE

POZICIONI I PUNËS: Specialist Biolog Detar

Orari i punës: me kohë të pjesshme (1400 ore pune)

Koha e punesimit: Qershor 2019 – Dhjetor 2021

Qëllimi i vendit të punës:

Të ofrojë mbështetje për anëtarët e ekipit të projektit AFRIMED për të arritur qëllimet e projektit duke kryer punë të saktë dhe në kohë të aktiviteteve të kërkimit shkencor të projektit.

Kritere që duhet të plotësoj/në kandidati/ët

Përpos kritereve të përgjithshme të përcaktuara në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit, kandidati duhet të plotësojë edhe kriteret e mëposhtme:

- Të zotëroj titullin: Profesor Doktor në Biologji Mjedisi ose Shkenca Mjedisi.
- Të jetë ekspert I fushës së Hidrobiologjisë, Ekologjisë detare dhe I ekologjisë së llojeve aliene dhe invasive.
- Të ketë së paku dhjetë vite eksperiencë në fushën e Biologjisë detare.
- Preferohen që kandidatët të njohin një prej pesë gjuhëve të Bashkimit Europian: Anglisht, Frëngjisht, Gjermanisht, Italisht, Spanjisht.
- Të ketë marrë pjesë në së paku pesë projekte ndërkombëtare që pëfshinë studime në biologji detare.
- Preferohen kandidatët të cilët kanë patur eksperiencë në drejtimin dhe menaxhimin e projekteve europiane në fushën e biologjisë detare.
- Preferohen kandidatët me aktivitet botues dhe kërkimor – shkencor ndërkombëtar në fushën e zoologjisë detare.
- Preferohen kandidatët me eksperiencë në metodikat e kampionimit dhe studimit nënujor nëpërmjet zhytjes me bombula.
- Të ketë aftësi si zhytës në së paku 10 metra thellësi dhe te ketë së paku 5 (pesë) vjet eksperiencë pune ne kete fushe.

Aktiviteti kërkues ku do të kontribojë kandidati:

- Studimi i biodiversitetit makrofitet bentik, vlerësimi i gjendjes së tyre ekologjike, shkalla e degradimit dhe shkaqet kryesore të shqetësimit të habitateve. E gjithë kjo nëpërmjet prezencës së llojeve të indikatorëve, mjedisit abiotik dhe pranisë së specieve të huaj.
- Koordinator I aktiviteteve të Rehabilitimit në terren dhe restaurimit të habitateve me Cystoseira në pellgun e Mesdheut”
- Hartëzimi i habitateve me Cystoseira në zonën e projektit.
- Vlerësimi i situatës ekologjike pas aktiviteteve të rehabilitimit.
- Hartimi i raporteve shkencore të projektit në bashkpunim me të gjithë stafin e projektit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT DHE BURIMEVE NJERËZORE

Informacione shitesë:

Informacioni bazë për projektin AFRIMED mund të gjendet në: <http://www.afrimed-project.eu/>.

Paga: Do të saktësohet gjatë intervistës

POZICIONI I PUNËS: Specialist Botanist detar (Algalog)

Orari i punës: me kohë të pjesshme (1400 ore pune)

Koha e punesimit: Qershor 2019 – Dhjetor 2021

Qëllimi i vendit të punës:

Të ofrojë mbështetje për anëtarët e ekipit të projektit AFRIMED për të arritur qëllimet e projektit duke kryer punë të saktë dhe në kohë të aktiviteteve të kërkimit shkencor në fushën e botanikës detare dhe algalogjisë.

Kritere që duhet të plotësoj/në kandidati/ët

Përpos kritereve të përgjithshme të përcaktuara në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit, kandidati duhet të plotësojë edhe kriteret e mëposhtme:

- Të zotëroj titullin: Profesor Doktor në Biologji Mjedisi ose Shkenca Mjedisi.
- Të jetë ekspert I fushës së Algalogjisë dhe Botanikës detare.
- Të ketë së paku dhjetë vite eksperiencë në fushën e Botanikës detare.
- Të ketë marrë pjesë në së paku pesë projekte ndërkombëtare që pëfshinë studime në biologji detare.
- Preferohen që kandidatët të njohin një prej pesë gjuhëve të Bashkimit Europian: Anglisht, Frëngjisht, Gjermanisht, Italisht, Spanjisht, të certifikuar sipas testeve të njohura ndërkombëtarisht (niveli B1), ose me dëshmi të dokumentuar nga Universiteti i Tiranës (të paktën nota 8). Nëse Kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
- Preferohen kandidatët të cilët kanë patur eksperiencë në drejtimin dhe menaxhimin e projekteve europiane në fushën e biologjisë detare.
- Preferohen kandidatët që kanë eksperiencë në metodat e hartëzimit të habitateve detare dhe makroalgave.
- Preferohen kandidatët me aktivitet botues dhe kërkimor – shkencor ndërkombëtar në fushën e botanikës detare.
- Preferohen kandidatët me eksperiencë në metodikat e kampionimit dhe studimit nënujor nëpërmjet zhytjes me bombula.
- Të ketë aftësi si zhytës në së paku 10 metra thellësi dhe të ketë së paku 5 (pesë) vjet eksperiencë pune.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT DHE BURIMEVE NJERËZORE**

Aktiviteti kërkues ku do të kontribojë kandidati:

- Studimi i biodiversitetit dhe vlerësimi i statusit ekologjik të makrofiteve bentike të shtratit të detit shkëmbor në zonat e përfshira në studim.
- Përcaktimi i specieve të gjinisë *Cystoseira*, dhe të algave dhe bimëve të tjera detare shoqëruase.
- Përcaktimi i stadeve të maturimit dhe kampionimi i gonadeve të specieve të ndryshme të gjinisë *Cystoseira* për procedurat e kultivimit in vitro.
- Hartëzimi i habitateve me *Cystoseira* në zonën e projektit.
- Hartimi i raporteve shkencore të projektit në bashkpunim me të gjithë stafin e projektit.

Informacione shtesë:

Informacioni bazë për projektin AFRIMED mund të gjendet në: <http://www.afrimed-project.eu/>.

Paga: Do të saktësohet gjatë intervistës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT DHE BURIMEVE NJERËZORE

POZICIONI I PUNËS: Asistent kërkues shkencor në Biologji detare (Algalogji)

Orari i punës: me kohë të pjesshme (1080 orë pune)

Koha e punesimit: Qershor 2019 – Dhjetor 2021

Qëllimi i vendit të punës:

Të ofrojë mbështetje për anëtarët e ekipit të projektit AFRIMED për të arritur qëllimet e projektit duke kryer punë të saktë dhe në kohë të aktiviteteve të kërkimit shkencor në fushën e botanikës detare dhe algalogjisë.

Kritere të përgjithshme që duhet të plotësoj/në kandidati/ët

- Të zotëroj aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurron;
- Të jetë i aftë të garantoj standartin e cilësisë dhe efikasitetin në kërkimin shkencor.
- Të ketë aftësinë e punës në grup dhe të komunikimit profesional me kolegët dhe studentët;
- Kandidati nuk duhet të ketë patur background negativ në eksperiencat e mëparshme në punë;
- Të mos jetë marrë ndaj tij masë disiplinore "largim nga puna" si dhe të mos jetë në proces gjyqësor me Universitetin "Isamil Qemali" Vlorë;
- Të mos ketë vepruar ose propaganduar në drejtim të prishjes së imazhit të universitetit dhe autoriteteve drejtuese të UV-së, në median vizive dhe/apo të shkruar, rrjetet sociale etj.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë i aftë nga ana shëndetësore;

Kritere të veçanta

Përpos kritereve të përgjithshme të përcaktuara në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit, kandidati duhet të plotësojë edhe kriteret e mëposhtme:

- Të zotëroj të paktën titullin: Doktor shkencash në Biologji Mjedisi ose në Biologji e ruajtjes së ekosistemeve.
- Të ketë së paku pesë vite eksperiencë në fushën e Botanikës dhe Biologjisë detare.
- Të ketë marrë pjesë në së paku një projekt ndërkombëtar që pëfshinë studime në biologji detare.
- Preferohen kandidatët që kanë eksperiencë në metodat e kampionimit dhe përcaktimit të makroinvertebrorëve dhe makroalgave detare.
- Preferohen kandidatët me aktivitete botues dhe kërkimor – shkencor ndërkombëtar në fushën e biologjisë detare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË DREJTORIA E KOMUNIKIMIT DHE BURIMEVE NJERËZORE

- Preferohen kandidatët që kanë eksperiencë në taksonomine dhe klasifikimin e makroalgave.
- Preferohen që kandidatët të njohin një prej pesë gjuhëve të Bashkimit Europian: Anglisht, Frëngjisht, Gjermanisht, Italisht, Spanjisht, të certifikuar sipas testeve të njohura ndërkombëtarisht (niveli B1), ose me dëshmi të dokumentuar nga Universiteti i Tiranës (të paktën nota 8). Nëse Kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

Aktiviteti kërkues ku do të kontribuojë kandidati:

- Të asistoj kërkues shkencor në fushën e botanikës dhe biologjisë detare në koordinimin e punës në terren dhe në laborator.
- Të mbledh dhe përpunoj të dhënat sipas indikatorëve ekologjik dhe statistikor mbi vlerësimin e gjendjes ekologjike të habitateve para dhe pas aktiviteteve të rehabilitimit të habitatit.
- Të asistoj ekspertët e fishës, në aktivitetet e vlerësimit të biodiversitetit bentik, në vlerësimin në terren dhe laborator.
- Të asistojë në hartimin e raporteve shkencore të projektit në bashkpunim me të gjithë stafin e projektit.

Informacione shtesë:

Informacioni bazë për projektin AFRIMED mund të gjendet në: <http://www.afrimed-project.eu/>.

Paga: Do të saktësohet gjatë intervistës

Procedura e aplikimit:

Ju lutem dërgoni në adresën postare të mëposhtme aplikimin tuaj:

Universiteti "Ismail Qemali" Vlore

Adresa: Skelë, Rruga Kosova, Vlorë 9401

Aplikimi duhet të përfshijë:

- CV në formatin Europass me theks në përshkrimin e punës që lidhet me aktivitetin e punës së AFRIMED
- Letra Motivimi
- Fotokopje të diplomave, certifikatave, etj, për të mbështetur dhe dëshmuar CV-në
- Rekomandime në formë të lirë nëse ka ndonjë?



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT DHE BURIMEVE NJERËZORE

Afati për aplikim

- ✓ Afati për të aplikuar është 2 dy (javë) kalendarike. Ky afat fillon nga data e nesërme e publikimit të njoftimit në web-site zyrtar të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë: www.univlora.edu.al. (njoftimi u publikua në datën 27.06.2019 dhe afati përfundon në datën 12.07.2019).
- ✓ Dokumentacioni i dorëzuar në shërbimin postar pas datës 12.07.2019, do t'i kthehet aplikantit pa veprime.